



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 28 qershor 2016, në mbledhjen e XXIV-të
(njëzetënentë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, Agron Gërguri, ud. i Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Rasim Fejza, koordinator për Energji efikente dhe Muharrem Haziri, OSBE.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi z. Mmehmet Gashi, në ndërkohë pas dërgimit të thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje në ndërkohë është paraqitur nevoja për shqyrtim të çështjeve në vijim:

- Propozimi i Vendimit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spitali i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës
- Propozimi i Vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ – Klubit publik të futbollit “ Llapi “ në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit në organizim në formën e Shoqërisë aksionare, dhe
- Propozimi i Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës e ka iniciuar procedurën për themelimin e Spitalit të

Përgjithshëm në Podujevë ngase është një prej komunave më të mëdha për nga sipërfaqja dhe për nga numri i banorëve. Përndryshe nevoja për ofrimin e shërbimeve dytësore shëndetësore është mëse e nevojshme.

Agron Gërguri, ud. i Drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, theksoi, konform krijimit të situatës së re pas pranimit të Federatës së Futbollit të Kosovës në UEFA dhe FIFA kërkohet një organizim i ri sipas rregullave strikte të organizatave të cekura. Në këtë kontekst Federata e futbollit të Kosovës të gjitha klubeve të futbollit dhe Drejtorive komunale përkatëse ua ka dërguar një Qarkore për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktiviteteve në cilësinë e klubeve publike dhe themelimit të klubeve private apo me organizim në formën e shoqërisë aksionare. Veprimi i këtillë është në interes të KF ' Llapi '.

Abaz Llughaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë, theksoi, kërkesa është shtruar në emër të KEDS – it por njëkohësisht është edhe kërkesë e qytetarëve të mjediseve përkatëse. KEDS – i ka filluar rindërtimin e rrjetit elektrik dhe është duke i ndërruar shtyllat dhe trafot ngase në disa lagje tensioni i rrymës elektrike është mjaftë i ulët dhe duke u bazuar në interesin e qytetarëve për ndërtimin e trafove të reja është propozuar miratimi i këtij vendimi.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, sa i përket pikave shtesë të rendit të propozuar të ditës jam i interesuar të di se kur është shtruar kërkesa e KEDS – it, nëse është bërë pas dërgimit të thirrjes dhe materialit për këtë mbledhje mund të pranohet si e arsyeshme por nëse kërkesa është bërë më herët nuk pajtohemi të përfshihet si pikë shtesë e rendit të ditës ngase përgjegjësia është e drejtorit të Drejtorisë përkatëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, në Grupi i këshilltarëve të LDK – së i përkrahim të tri pikat shtesë të propozuara duke u mbështetur në peshën dhe rëndësinë që e kanë në ndikimin e drejtpërdrejtë në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës tonë.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, dëshiroj të ndërlidhem me vërejtjen e z. Rafet Llapashticës dhe pajtohemi që në të ardhmen pika shtesë të propozohen vetëm çështjet e natyrës së ngutshme, pra Drejtoritë janë përgjegjëse që me kohë të përgatitin materialet dhe të konsultohen me Kryetarin e Komunës për procedimin e materialeve për shqyrtim në Kuvend.

Abaz Llughaliu, theksoi, kërkesa e KEDS –it është shtruar më 06.06.2016, mirëpo kemi pasë hezitim për shkak se kërkesat kanë qenë të shumta dhe në disa raste paluajtshmëria nuk ka qenë në pronësi të Komunës, në disa raste prona është identifikuar publike dhe këto raste nuk janë propozuar meqë nuk është në kompetencë të Komunës, pra është dashur të sqarohet çdo rast veç e veç në mënyrë që mos të lëshohet ndonjë gabim. Propozimet e vendimeve të kësaj natyre bëhen vetëm për interes të qytetarëve.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, në emër të Grupi i këshilltarëve i PDK – së u paraqit një vërejtje serioze duke u bazuar në afatin e paraparë me dispozita ligjore lidhur me pikat shtesë për rendin e ditës e kjo vërejtje bazohet në afatin e paraparë ligjor për dërgimin e materialeve të mbledhjeve e ky afat është 7 para mbajtjes së mbledhjeve të rregullta dhe 3 ditë para mbajtjes së mbledhjeve të jashtëzakonshme, dhe duke u bazuar në këtë arsye dhe neglizhencën e drejtorit të Drejtorisë së Pronës, Kadastrit dhe Gjeodezisë ngase vet e pranoi se kërkesa përkatëse nga KEDS – i është shtruar para dërgimit të materialit për këtë mbledhje, andaj këtë pikë të propozuar të rendit të ditës ne nuk e mbështesim.

Pas votimit u konstatua se në kuadër të rendit të propozuar të ditës u përfshinë edhe 3 (tri) pika shtesë, dhe atë, njëzëri:

- **Propozimi i vendimit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spital i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës**
- **Propozimi i vendimit për inicimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ - Klubit Publik të futbollit “Llapi“ në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit me organizim në formën e shoqërisë aksionare**

Ndërsa,

Me 7 vota për, asnjë votë kundër, 2 vota të përmbajtura:

- **Propozimi i vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike- KEDS**

2. Shqyrtimi i Ekstrakteve të procesverbaleve të mbajtura në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa më 29 mars 2016 dhe 28 prill 2016

z. Rafet Llapashtica, theksoi, kohëve të fundit ekstraktet e procesverbaleve nuk dërgohen me kohë siç është e paraparë dhe atë në mbledhjen vijuese, andaj në këtë drejtim duhet pasë kujdes në mënyrë që të mos ndodhë si në këtë rast që të bëhen tri ekstrakte të procesverbaleve pa u dërguar.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, vërejtja e parafolësit është me vend dhe në të ardhmen do të kërkohet nga Zyra ligjore që të ketë kujdes në këtë drejtim.

Në vazhdim pas votimit u konstatua se Ekstrakti i procesverbalit të datës 29 mars 2016 u miratua pa vërejtje, ndërsa Ekstrakti i procesverbali të datës 28 prill 2016 me korigjim në diskutimin e z. Naim Çunakut, në 8 – 9, si vijon “ gjerësia e dërrasave mbulohet kufoma të jetë 200 cm, gjatësia 115 cm dhe trashësia 0.5 apo 5 cm “.

3. Korniza Afatmesme Buxhetore 2017 – 2019

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekalii, theksoi, drejtori në fjalën hyrëse e sqaroi në mënyrë detaje andaj unë nuk kam çfarë të shtoj por vetëm të urojmë që kjo Kornizë Afatmesme Buxhetore të realizohet sa më shumë që është e mundshme.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, jam i interesuar të di se në kuadër të Drejtorisë së planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit përse janë hijezuar disa projekte, ndërsa sa i përket Drejtorisë së Administratës pyetja ka të bëjë me atë se në cilën fazë është ndërtimi i objektit të ri të Komunës dhe shtoi, këtë pyetje e shtoi duke u bazuar se për objektin e ri është paraparë një shumë mjaftë e madhe buxhetore.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, theksoi, projektet e hijezuara kanë të bëjnë me Memorandumin e nënshkruar për periudhën dyvjeçare dhe vazhdoi, sa i përket objektit të ri të Komunës në jemi të informuar që punimet do të përfundojnë deri më 31 dhjetor 2017.

z. Haki Rudari, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore është dokument shumë i rëndësishëm mirëpo përkundër kësaj vërejtjet të cilat ne i kemi dhënë në vazhdimësi nuk janë përfillë dhe planifikimet e parapara buxhetore kanë të meta dhe gabime të cilat duhet korrigjuar ngase jemi të mendimit se një numër i projekteve nuk janë të qëlluara për faktin se në disa mjedise janë koncentruar, projekte për të cilat më detajisht do të diskutoj në mbledhjen e nesërme të Kuvendit.

Pas votimit u konstatua se Korniza Afatmesme Buxhetore, Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.

4. Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme për Komunën e Podujevës

z. Rasim Fejza, koordinator për energji në kuadër të Administratës së Komunës, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, Grupi i këshilltarëve i PDK – së e mbështet këtë dokument dhe uron që i njëjti të implementohet.

z. Haki Rudari, theksoi, Grupi i këshilltarëve i LVV – së në parim e mbështet këtë dokument.

Kryesuesi z. Mehmet Gashi, theksoi, në faqen 26 të këtij dokumenti thuhet se Zyra e Kryetarit të Komunës i ka dy nënkryetarë dhe shefin e kabinetit, që është gabim dhe duhet korrigjuar por ka nevojë të korrigjohen edhe gabime të tjerë.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim, me korrigjim të gabimeve teknike dhe gjuhësore.

5. Propozimi i Vendimit për fillimin e procedurave për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Podujevës

z. Durim Saluhu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

6. Propozimi i Vendimit për organizimin e kujdesit dytësor shëndetësor – Spital i Përgjithshëm në Komunën e Podujevës

Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

7. Propozimi i Vendimit për iniciimin e procedurave për ndërprerjen e aktivitetit të OJQ – Klubit publik të futbollit “ Llapi “ në Podujevë me qëllim të themelimit të klubit në organizim në formën e Shoqërisë aksionare

z. Agron Gërguri, u.d. drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Haki Rudari, theksoi, disa herë kam paraqitur vërejtje për pikat shtesë të rendit të ditës të cilat propozohen para fillimit të mbledhjes, kjo praktikë është duke u përsërit edhe në mbledhjen e sotme, unë e respektoj vullnetin e shumicës por konsideroj se fillimisht do duhej të kishim një informatë nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit por duhet të jemi

të kujdesshëm se me këtë veprim po shuhet një klub me renome dhe traditë mjaftë të gjatë

Pas votimit u konstatua se me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur, Kuvendit i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

8. Propozimi i Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS

z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi, theksoi, vërejtja ime është parimore dhe dëshiroj që askush të mos e merr personale, konsideroj se nuk është në rregull që të jepen sqarime për një individ ngase koha për fillimin e mbledhjes caktohet më parë së bashku me rendin e propozuar të ditës dhe nëse ndokush vonohet nuk ka nevojë që të njëjtit t'i jepen informata shtesë për rrjedhën e mbledhjes.

z. Haki Rudari, theksoi, kolegeja punon në lëmin e arsimit dhe duhet ta di se çdo mbledhje duhet të jetë transparente, ne jemi njerëz dhe kemi obligime familjare dhe të tjera, përndryshe jam një prej atyre që e respekton më së tepërmi orarin e mbajtjes së mbledhjeve.

Sqarimet të cilat po i jep kryesuesi z. Mehmet Gashi, jo vetëm sot, është formë shumë pozitive ngase e ngritë transparencën dhe e largon mjegullën nëse eventualisht krijohet. Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 13.50'.

**Procesverbalin e mbajti
Faik Gashi**

**Nr. 01-006-52447
Podujevë,
28 qershor 2016**

**Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi**